National Albanian
Real Estate Association
Trademark in Protection Process by Number AL/T/2026/5.

NEWSLETTER

PRILL – QERSHOR 2026

Nr. 2 / 2026 — Botim i NAREA, National Albanian Real Estate Association

NË KËTË NUMËR

- Scott Sorrell Trajnime: Tiranë dhe Vlorë
- Dialog me IMF & World Bank Group
- MONEYVAL – Raundi i 6-të i Vlerësimit
- Partneriteti strategjik NAREA & CIPE
- “The Right Start” & “Train the Trainer”
- Projektligji i ri AML/CFT me AIF

TRAJNIME

Trajnim me ekspertin ndërkombëtar Scott Sorrell.

Sesion ekskluziv për anëtarët e NAREA • Me Leader Impact Albania - Prill 2026

Në muajin Prill, u zhvillua një trajnim ndryshe me trajnerin Scott Sorrell një sesion ekskluziv për anëtarët e NAREA-s, në bashkëpunim me Leader Impact Albania, i fokusuar në rritjen e performancës dhe fuqizimin e aftësive në shitje.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë si t'i vënë në praktikë aftësitë e tyre për t'u bërë shitës më të suksesshëm, duke përvetësuar teknika konkrete për të krijuar vlerë, për të ndërtuar besim me klientët dhe për të mbyllur më shumë transaksione pa ulur komisionin.

Përmes shembujve praktikë, strategjive të provuara dhe qasjes energjike të trajnerit, ky trajnim solli një perspektivë të re mbi mënyrën si profesionistët e pasurive të paluajtshme mund të diferencohen në një treg gjithnjë e më konkurrues.

"Të krijosh vlerë, të ndërtosh besim dhe të mbyllësh më shumë transaksione, pa ulur komisionin."

TRAJNIME

Rrugëtimi vijon: trajnimi me Scott Sorrell në Vlorë.

Në bashkëpunim me Leader Impact Albania - Prill 2026

Angazhimi i NAREA-s për të trajnuar, motivuar dhe fuqizuar aktorët e tregut të pasurive të paluajtshme vijon me intensitet. Udhëtimi i radhës na çoi në Vlorë, ku zhvilluam një trajnim dinamik me trajnerin ndërkombëtar Scott Sorrell.

Ky sesion solli një qasje praktike dhe të drejtpërdrejtë mbi elementët kyç të suksesit në shitje:

- **Identifikimin e klientëve potencialë**
- **Ndërtimin e marrëdhënieve të besimit afatgjatë**
- **Analizimin e nevojave reale të klientit**
- **Prezantimin efektiv të vlerës**
- **Kapërcimin e kundërshtimeve me profesionalizëm**
- **Teknikat e mbylljes së shitjes**
- **Kontaktin dhe ndjekjen pas shitjes**

Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit u pajisën me informacione konkrete dhe strategji të zbatueshme për t'u vendosur në praktikë, duke rritur kështu standardet e shërbimit dhe të performancës në industrinë e Real Estate në Shqipëri.

NAREA mbetet e përkushtuar për të sjellë eksperienca që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen profesionale të anëtarëve dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut.

INSTITUCIONALE

NAREA në Tryezën Kombëtare për AML/CFT.

Ndërveprimi institucional për mbikëqyrje efektive • Projekti MATRA - Prill 2026

Të nderuar të ishim pjesë e Tryezës Kombëtare të Forcimit të Ndërveprimit Institucional për Mbikëqyrje Efektive, organizuar në kuadër të Projektit MATRA të Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri.

Si pjesë e Panelit 2, krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Hetimit Tatimor, NAREA kontribuoi me pikëpamjen e komunitetit për Real Estate dhe efektivitetin në AML/CFT.

3 SHTYLLAT KRYESORE SIPAS NAREA

1. **Supervizimi “smart” —** dhe partneriteti strategjik i munguar.
2. **Kapacitetet —** nevoja për kapacitete që mund të zhvillohen në vijim.
3. **Aleanca Funksionale —** mes aktorëve kyç: NAREA – ASHK – Ministria e Drejtësisë – Hetimi Tatimor – Inteligjenca Financiare.

NAREA po përgatit, në bashkëpunim me partnerë strategjikë institucionalë, një kuadër politikash që i adreson këto boshllëqe direkt në burim, jo përmes më shumë kontrolleve mbi transaksionet legjitime, por përmes një infrastrukture të dhënash dhe procesesh që i bën transaksionet jo-legjitime të dukshme.

TREGU & INSTITUCIONET

Raporti i Bankës së Shqipërisë: Konfirmon analizat e NAREA-s.

Raporti i Stabilitetit Financiar i Bankës së Shqipërisë • 6M-II 2025 - Prill 2026

Banka e Shqipërisë ka publikuar Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të 2025-ës, si dhe një përmbledhje të ecurisë vjetore. Sektori i Real Estate performon pozitivisht, me kërkesë të brendshme të qëndrueshme dhe interes pozitiv nga blerësit e huaj të cilët gjatë vitit të fundit kanë treguar diversitet më të madh, me uljen e përqendrimit me origjinë nga Bashkimi Evropian dhe rritjen e prejardhjes nga tregje të tjera globale.

Për herë të parë, Vrojtimi i Bankës së Shqipërisë vjen në nivelin e parashikimeve të NAREA, duke konfirmuar gjetjet tona dhe dinamikat reale të tregut. Tirana, në tre vitet e fundit, ka përjetuar ngadalësim të ritmit të rritjes së çmimeve, ndërsa Bregdeti i ndikuar nga kërkesa e blerësve të huaj, kërkesa për produkt investimi dhe projektet e reja zhvillimore premtuese vazhdon të shënojë rritje të qëndrueshme dyshifrore.

4.4%

Rritja e çmimeve në Tiranë
(2025 kundrejt 2024)

2-shifrore

Rritja e qëndrueshme e çmimeve
në Bregdetin shqiptar

6M-II 2025

Raporti i Stabilitetit Financiar,
Banka e Shqipërisë



Pamje nga Raporti i Stabilitetit Financiar – Banka e Shqipërisë

INSTITUCIONALE

Forcimi i Stabilitetit Financiar: NAREA në dialog me IMF dhe World Bank Group.

Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë • Prill 2026

Më 28 prill, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, NAREA e përfaqësuar nga Arbër Brahaj (Anëtar i Bordit) dhe Reinaldo Pipiria mirëpriti një delegacion të përbashkët nga International Monetary Fund dhe World Bank Group. Ky ishte raundi i dytë (takimi i tretë radhazi) i një procesi të rëndësishëm konsultimesh strategjike, i fokusuar në stabilitetin financiar të Shqipërisë.

Misioni shërbeu si platformë për të diskutuar rëndësinë sistemike të sektorit të pasurive të paluajtshme në kuadrin makroekonomik të vendit, duke theksuar domosdoshmërinë e një kuadri të fortë rregullator dhe të praktikave transparente të tregut.

PIKAT KRYESORE TË DISKUTIMIT

1. **Mbikëqyrja makroprudenciale**
   Vlerësimi i ndikimit të dinamikave të tregut të pasurive të paluajtshme në sistemin financiar në tërësi.

2. **Reformat strukturore**
   Nisma politikash që synojnë rritjen e transparencës dhe reduktimin e rreziqeve në sektor.

3. **Bashkëpunimi ndërkombëtar**
   Harmonizimi i praktikave kombëtare me standardet ndërkombëtare për forcimin e stabilitetit financiar.

Falenderojmë përfaqësuesit e IMF dhe World Bank Group për kontributin dhe analizat e vlefshme. NAREA mbetet e përkushtuar të bashkëpunojë me institucionet ndërkombëtare për të promovuar një mjedis financiar të sigurt dhe të qëndrueshëm për Shqipërinë.

NAREA në takimin me Misionin e MONEYVAL.

Raundi i 6-të i Vlerësimit të Ndërsjellë • Prill 2026

Muaji prill 2026 shënoi një moment të rëndësishëm për përputhshmërinë me standardet AML/CFT në Shqipëri, për procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe për sektorin e pasurive të paluajtshme, si një nga sektorët kryesorë të ekonomisë.

Më 14 mars 2025, MONEYVAL nisi zyrtarisht Raundin e 6-të të Vlerësimit të Ndërsjellë të Shqipërisë, procesi kyç që do të përcaktojë mënyrën se si komuniteti ndërkombëtar do të vlerësojë kuadrin shqiptar të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vitet në vijim. Si sektor, pasuritë e paluajtshme nuk mund të jenë thjesht vëzhguese në këtë proces.

Më 20 prill, NAREA e përfaqësuar nga Dritan Caka (Kryetar), Ilda Zaloshnja (Nënkryetare), Ledia Telhai (Anëtare e Bordit), Eltion Koci (Anëtar) dhe Ada Gramatiku Cenko LL.M. (Drejtuese e Departamentit Ligjor dhe Oficere e Përputhshmërisë), zhvilloi një takim të rëndësishëm me Misionin e Monitorimit dhe Vlerësimit të MONEYVAL në Tiranë.

Pse ka rëndësi ky proces?

Pas takimeve të vitit 2018 dhe 2023 (ICRG Group), ky takim i tretë me FATF/MONEYVAL vjen në një moment kur sektori vazhdon të klasifikohet me rrezik mesatar në Vlerësimin Kombëtar të Riskut, ndërsa DNFBP-të, përfshirë agjentët e pasurive të paluajtshme, janë nën vëmendje të drejtpërdrejtë të metodologjisë së Raundit të 6-të, me fokus tek efektiviteti i zbatimit dhe jo vetëm përputhshmëria formale. Heqja e Shqipërisë nga Lista Gri e FATF në tetor 2023 është një arritje që edhe sektori ynë duhet të kontribuojë për ta ruajtur.

Vlerësuesit analizojnë rezultate konkrete në praktikë: a identifikohen dhe raportohen transaksionet e dyshimta; a zbatohen realisht detyrimet e Due Diligence; a është sektori privat i integruar efektivisht në sistemin kombëtar AML/CFT.

Një treg i pasurive të paluajtshme që funksionon mbi transparencë dhe standarde ndërkombëtare është avantazh konkurrues për investitorët, për integrimin në BE dhe për reputacionin e Shqipërisë.

INSTITUCIONALE

Çmimet referuese: NAREA dhe Ministria e Financave.

Grupi ndërinstitucional i punës për çmimet mesatare referuese - Maj 2026

Në Ministrinë e Financave u zhvillua takimi i radhës i grupit ndërinstitucional të punës për përcaktimin e çmimeve mesatare referuese të banesave për qëllime fiskale, me pjesëmarrjen e NAREA dhe të Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë. Gjatë takimit u diskutua mbi situatën aktuale të tregut të pasurive të paluajtshme, metodologjinë e vlerësimit dhe rëndësinë e bashkëpunimit me ekspertët e tregut dhe të sektorit të ndërtimit, në funksion të hartimit të çmimeve referuese sa më realiste dhe transparente.

PARTNERITETE

NAREA & GTNP: Aleanca kundër Krimit Financiar.

GTNP - Maj 2026

Në vitin e tretë të GTNP – The Albanian Anti-Financial Crime Alliance – NAREA vazhdon të përfaqësojë aktivisht pikëpamjen e sektorit për adresimin e sfidave të AML/CFT në Real Estate, duke mbështetur rrugëtimin e qëndrueshëm të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.

TRAJNIME

Përfundoi me sukses trajnimi “The Right Start”

Programi 2-ditor për agjentët e rinj të pasurive të paluajtshme - Maj 2026

NAREA përfundoi me sukses trajnimin 2-ditor “The Right Start”, një program i dedikuar për agjentët e rinj të pasurive të paluajtshme dhe profesionistët që synojnë të ndërtojnë një karrierë të suksesshme në sektor.

Përmes sesioneve praktike dhe shkëmbimit të eksperiencave me profesionistë të fushës, pjesëmarrësit zhvilluan njohuritë dhe aftësitë e tyre, duke krijuar një bazë të fortë për rrugëtimin e tyre profesional.

Falenderojmë trajnerët dhe të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe kontributin në suksesin e këtij programi.

Nga Vlerësimi në Veprim

CIPE – Center for International Private Enterprise

NAREA dhe CIPE nisin një partneritet strategjik për të ardhmen e sektorit të pasurive të paluajtshme - Qershor 2026

NAREA dhe CIPE – Center for International Private Enterprise po nisin së bashku një program strategjik zhvillimi, që synon të forcojë profesionin e pasurive të paluajtshme dhe kuadrin rregullator në Shqipëri. Përmes këtij partneriteti, ne kalojmë:

Nga Vlerësimi → **në Veprim**

Nga Përputhshmëria (Compliance) → **në Kulturë**

Nga një sektor që zbaton rregullat → **në një sektor që kontribuon në hartimin e tyre**

Mirënjohës për partneritetin me CIPE dhe për lidershipin e Edval Zoto, CFE, CAMS, NPP. Krenarë për rrugëtimin e NAREA. Të entuziazmuar për atë që na pret. Profesionistëve të pasurive të paluajtshme, institucioneve rregullatore dhe partnerëve institucionalë, kjo është një punë që na përket të gjithëve.

E ardhmja e profesionit ndërtohet sot. Le ta ndërtojmë së bashku.

TRAJNIME

Train the Trainer: pika e nisjes për trajnerët e së ardhmes.

2 ditë intensive zhvillimi profesional • Me trajneren Zola Szerencses - Qershor 2026

Pas dy ditësh intensive plot energji, mësim dhe zhvillim profesional, përfunduam me sukses trajnimin “Train the Trainer”.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe entuziazmin e treguar, si dhe trajneren Zola Szerencses për profesionalizmin, përkushtimin dhe energjinë frymëzuese që përcolli gjatë gjithë trajnimit.

Shpresojmë që ky trajnim të ketë qenë një eksperiencë e vlefshme për secilin prej pjesëmarrësve, duke i pajisur me njohuri të reja, besim dhe motivim për të vazhduar rritjen dhe zhvillimin profesional.

Ju urojmë suksese të mëtejshme, kjo është vetëm pika e nisjes për trajnerët e së ardhmes!

“Kjo është vetëm pika e nisjes për trajnerët e së ardhmes.”

PARTNERITETE

NAREA në workshopin rajonal të CIPE për forcimin e kapaciteteve.

Workshop 2-ditor me Organizatat e Biznesit të Ballkanit Perëndimor (WB6) - Qershor 2026

Si pjesë e projektit me Center for International Private Enterprise për forcimin e kapaciteteve, NAREA mori pjesë në workshopin 2-ditor me Organizatat e Biznesit të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë workshopit u thelluan njohuritë mbi karakteristikat, aftësitë dhe kapacitetet e organizatave të suksesshme. Gjithashtu, u ndanë njohuri të reja mbi zbatimin e suksesshëm të projekteve, duke njohur të gjithë procesin e zhvillimit dhe monitorimit të tyre.

Ndërmjet organizatave të tjera nga WB6, këto dy ditë ishin një shkëmbim i vlefshëm eksperiencash dhe një mundësi për të ndërtuar bashkëpunime, duke forcuar dimensionin rajonal të ndikimit të NAREA.

Falenderojmë CIPE për besimin, mbështetjen dhe mundësinë për të qenë pjesë e këtij programi të rëndësishëm.

“Forcimi i dimensionit rajonal të ndikimit të NAREA në Ballkanin Perëndimor.”

INSTITUCIONALE

NAREA kontribuon në konsultimin e Projektligjit të ri për AML/CFT.

NAREA & AIF – Agjencia e Inteligjencës Financiare - Qershor 2026

NAREA dhe AIF – Agjencia e Inteligjencës Financiare vijnë bashkë në konsultimin e Projektligjit të ri për AML/CFT në Shqipëri.

Më 25 qershor, në ambientet e NAREA, u zhvillua konsultimi mbi harmonizimin e kuadrit rregullator AML/CFT në Shqipëri, kryesisht me direktivën AMLD5 2024/1640 dhe rregulloren AMLR6 2024/1624 të Bashkimit Evropian.

Përafrimi dhe harmonizimi, të mbështetura mbi parimin e qëndrueshmërisë dhe pavarësisë së vetë AIF, janë disa nga aspektet që duhen marrë në konsideratë teksa procesi i draftimit avancon.

Vetë-rregullimi i sektorit të Real Estate, si subjekt i detyruar, është themeli i suksesit të çdo ndërhyrjeje në këtë drejtim.

Falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit për kontributin, angazhimin dhe gatishmërinë për të qenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm.

National Albanian
Real Estate Association
Trademark in Protection Process by Number AL/T/2026/5.

#YourEdgeInRealEstate

narea.al

info@narea.al

member.narea.al

NEWSLETTER • NR. 2 • PRILL – QERSHOR 2026

© 2026 NAREA – National Albanian Real Estate Association

+335 69 40 40 150 / +355 69 40 40 240